



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 73 Akti

Nr. 229 Vendimi

Tiranë, më 28.1.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|----------------------------|------------------|
| Brunilda Bekteshi | Kryesuese |
| Suela Zhegu | Relatore |
| Valbona Sanxhaktari | Anëtare |

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, në Tiranë, në datën 27.1.2020, ora 9:00, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Dritan Banushi**, me funksion gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, i cili pranoi rezultatet e hetimit dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, DH, E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Banushi, aktualisht me funksion gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, në bazë të pikës 3, nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.1.2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në përfundim të shortit rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Banushi, do të shqyrtohet nga trupi gjykues, i cili përbëhet nga komisionerët: Suela Zhegu relatores, Valbona Sanxhakteri dhe Brunilda Bekteshi, anëtare.

Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), në përputhje me nenet 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), në përputhje me nenet 34 – 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në përputhje me nenin 43, të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatores së çështjes vendosi përfundimin e hetimit

kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Banushi, si dhe njoftimin e subjektit në datën 26.12.2019 për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit paraprak, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Për një proces të rregullt ligjor z. Dritan Banushi i janë garantuar të drejtat si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërja e trupit gjykues; si dhe për përfundimin e hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës për të paraqitur shpjegime dhe prova mbi rezultatet e hetimit paraprak brenda një afati 5-ditor.

Z. Dritan Banushi ka paraqitur shpjegimet dhe provat e tij brenda afatit të caktuar në datën 13.1.2020.

Trupi gjykues i mbledhur në datën 17.1.2020, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi administroi dhe shqyrtoi provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti, vendosi të ftojë z. Dritan Banushi në seancë dëgjimore në datën 27.1.2020, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 27.1.2020, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht dhe shprehu opinionin në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Banushi, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI RIVLERËSIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

Referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin Dritan Banushi, me funksion gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, u krye bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë; kontrollit të figurës; dhe të aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/1 RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, për: (a) verifikimin e vërtetësisë së deklaramëve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (b) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (c) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; (ç) evidentimin e deklaramëve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar në pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, nga ku rezulton se:

Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, datë 27.1.2017, z. Dritan Banushi, ka deklaruar këto pasuri:

1. Depozitë në vlerën 3.091.580 lekë, në “Alpha Bank”.
2. Depozitë në vlerën 2.000.000 lekë, në ABI me afat 36-mujor.
3. Depozitë në vlerën 700.000 lekë, në ABI me afat 36-mujor.
4. Llogari rrjedhëse në vlerën 489 lekë, në NBG.
5. Gjendje *cash* në vlerën 5.000 USD.
6. Automjet tip “Audi”, vit prodhimi 2001, me vlerë 3.800 euro + 231.064 lekë.
7. Apartament banimi në posedim, në Gjirokastër.

Pasuri të regjistruara veçmas në pronësi të bashkëshortes:

8. Apartament me sip. 67.6 m², në pronësi të bashkëshortes, në Gjirokastër, fituar me testament nga babai.
9. Llogari rrjedhëse në vlerën prej 7.714 lekësh në ABI, në emër të bashkëshortes.
10. Llogari kursimi në vlerën 6.906 euro, në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të vajzës së subjektit.
11. Llogari rrjedhëse në vlerën 68.432 lekë, në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të vajzës së subjektit.

Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka verifikuar saktësinë e deklaramëve dhe ka analizuar mundësinë financiare të subjektit dhe personave të lidhur për krijimin e pasurive me burime të ligjshme.

Lidhur me pasuritë e deklaruara

1. Depozitë në vlerën 3.000.000 lekë, krijuar në datën 31.12.2014, në “Alpha Bank”.

1.1 Burimi i krijimit: në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi pakësimin e gjendjes *cash* jashtë sistemit bankar, të deklaruar ndër vite nga pagat e tij dhe të bashkëshortes.

1.2 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

“Alpha Bank” ka konfirmuar se subjekti dhe bashkëshortja kanë llogari të përbashkët në këtë bankë. Nga verifikimi i kësaj llogarie konstatohet se në datën 30.12.2014 është depozituar *cash* shuma 3.000.000 lekë.

1.3 Analiza e fakteve

Komisioni analizoi deklaratat periodike vjetore nga ku vërehet se depozita është krijuar në muajin dhjetor të vitit 2014. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, subjekti ka deklaruar se për krijimin e kësaj depozite kanë shërbyer të ardhurat në vitet 1994 – 2015. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, subjekti ka deklaruar pakësimin e të gjithë gjendjes *cash*, të mbartur nga vitet e mëparshëm për shkak të blerjes së autoveturës.

Nisur nga të dhënat e mësipërme, duket se për krijimin e kësaj depozite nuk mund të kenë shërbyer të ardhurat e përfituara nga subjekti dhe bashkëshortja për vitet 1994 – 2006, si edhe të ardhurat e përfituara në vitin 2015. Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë këtë konstatim.

1.4 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka shpjeguar se: *“Konkluzioni i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i saktë për sa i përket faktit se burimi i krijimit të kësaj depozite nuk mund të jenë të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes sime për vitet 1994 – 2015, por kursimet nga të ardhurat e viteve 2007 – 2014. Kjo është thjesht një pasaktësi në shprehje, për sa i përket periudhës dhe jo një pasaktësi për sa i përket thelbit të analizës së burimeve, pasi burimi ‘kursimet familjare ndër vite’ është deklaruar saktë prej meje”*.

Gjithashtu, Komisioni analizoi deklaratat periodike vjetore në lidhje me gjendjen *cash* të deklaruar për vitet 2007 – 2014, që ka shërbyer si burim për krijimin e kësaj depozite.

Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2008 rezulton se subjekti ka deklaruar gjendje *cash* (shtesa), shumën prej 700.000 lekësh; referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2009 rezulton se subjekti ka deklaruar gjendje *cash* (shtesa), shumën prej 800.000 lekësh; referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2010 rezulton se subjekti ka deklaruar gjendje *cash* (shtesa), shumën prej 700.000 lekësh; referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2011 rezulton se subjekti ka deklaruar gjendje *cash* (shtesa), shumën prej 600.000 lekësh; referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2012 rezulton se subjekti ka deklaruar gjendje *cash* (shtesa), shumën prej 700.000 lekësh; referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2013 rezulton se subjekti ka deklaruar gjendje *cash* (shtesa), shumën prej 900.000 lekësh; referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2014 rezulton se, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar:

- a) gjendje *cash* (shtesë) në shumën prej 1.000.000 lekësh, nga të ardhurat e kursyera nga pagat;
- b) depozitë në shumën prej 3.000.000 lekësh, krijuar në datën 30.12.2014, në “Alpha Bank”;

c) pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar ndër vite, shumën 3.652 euro, shpenzim për arsimimin e vajzës.

Nga verifikimi i deklarimeve periodike ka rezultuar se subjekti i ka deklaruar rregullisht kursimet e tij.

- ✓ Për sa më sipër, u konstatua se deklarimet e subjektit përputhen me gjendjen *cash* të akumuluar jashtë sistemit bankar për vitet 2007 – 2014.

1.5 Analiza financiare

Komisioni ka kryer analizën për të vlerësuar mundësitë financiare të subjektit dhe të bashkëshortes për krijimin e kësaj depozite, nga ku rezulton se subjekti ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për krijimin e likuiditeteve *cash* të deklaruar në vite, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj depozite.

2. Depozita në ABI Bank

2.1 Depozitë me vlerë 2.000.000 lekë, krijuar në datën 31.12.2015, me afat 36-mujor në ABI.

Si burim krijimi subjekti ka deklaruar: (1) vlerën prej 1.500.000 lekësh nga mbyllja e depozitës me nr. reference ***, në “Alpha Bank”; (2) vlerën prej 500.000 lekësh nga pakësimi i gjendjes *cash* jashtë sistemit bankar, të deklaruar ndër vite nga pagat e të dy bashkëshortëve.

2.2 Depozitë me vlerë 700.000 lekë, krijuar në datën 31.12.2016, me afat 36-mujor në ABI.

Si burim krijimi subjekti ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* jashtë sistemit bankar të deklaruar ndër vite, si edhe kursimet për vitin 2016.

2.3 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ në lidhje me këto dy depozita

ABI¹ ka konfirmuar gjendjen e depozitave në lekë në këtë bankë, në shumat respektive 2.000.000 lekë dhe 700.000 lekë.

- ✓ Në lidhje me këto dy depozita konstatohet se deklarimet e subjektit përputhen me të dhënat e marra nga ABI.

2.4 Analiza financiare lidhur me mundësinë e krijimit të dy depozitave në ABI

Komisioni kreu analizën financiare me qëllim analizimin e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e depozitave: (1) depozitë në vlerën prej 3.091.580 lekësh , në “Alpha Bank”; (2) depozitë në vlerën prej 2.000.000 lekësh, në ABI; dhe (3) depozitë në vlerën prej 700.000 lekësh , në ABI, të deklaruar si të krijuara nga kursimet ndër vite.

Analiza financiare përmban analizën e të ardhurave, duke evidentuar të ardhurat e realizuara nga subjekti dhe nga bashkëshortja, bazuar në vërtetimet e lëshuara nga institucionet përkatëse dhe të administruara në dosjen e ILDKPKI-së.

Analiza e shpenzimeve, ku përfshihen: (1) shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas ILDKPKI-së, e cila bazohet në të dhënat e INSTAT-it; (2) shpenzimet për udhëtimet janë llogaritur bazuar në deklaratat e subjektit dhe rekordet e gjeneruara nga sistemi *TIMS*; (3) shpenzimet e shkollimit: shpenzimet e shkollimit të djalit janë dokumentuar sipas vërtetimit përkatës nga institucioni arsimor “****”; në qershor të vitit 2013, vajza e subjektit ka kryer një udhëtim disa ditë me destinacion qendrën “****” në Britaninë e Madhe, ku deklarohet se shpenzimet e

¹ Shkresa me nr. *** prot., datë 27.2.2018.

udhëtimit janë paguar nga prindërit e subjektit në shumën prej 290.000 lekësh, provuar kjo edhe me deklaratën noteriale² të z. S. B. I pyetur për burimin e të ardhurave, subjekti ka deklaruar se burim për këtë shpenzim kanë qenë të ardhurat nga bletaria dhe vreshtaria e prindërve, si dhe kursimet e tyre në vite. Nuk janë marrë në konsideratë këto burime në analizë, duke qenë se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për të provuar krijimin e të ardhurave nga prindërit; (4) shpenzime arredimi për banesën, të shpërndara ndër vite, sipas periudhës dhe shumave përkatëse të deklaruara nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve.

Gjendjet e llogarive bankare janë verifikuar nga dokumentet “*lëvizje e llogarive bankare*”, të administruara në dosje, bazuar në dokumentacionin e dërguar nga bankat për subjektin dhe personat e lidhur. Gjendja e kursimeve *cash* bazuar në deklaratimet periodike ndër vite.

2.5 Konstatime të Komisionit

Komisioni, në përfundim të rezultateve paraprake të hetimit, ka konstatuar se subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e dy depozitave në ABI, kursimet *cash* apo shpenzimet e kryera. Referuar analizës financiare për periudhën 2003 – 2016, ka rezultuar një balancë negative:

për vitin 2013, në shumën 264. 068 lekë;
për vitin 2014, në shumën 132. 520 lekë;
për vitin 2015, në shumën 303. 352 lekë;
për vitin 2016, në shumën 297. 826 lekë.

Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën në lidhje me këto konstatime.

2.6 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Në prapësime, subjekti ka shpjeguar dhe ka paraqitur dokumentacion provues, duke pretenduar:

1. Ulje të shpenzimeve për udhëtimet jashtë vendit për arsye pune.
2. Shpenzimet jetike në analizën financiare janë përlllogaritur dy herë: për periudhën kur vajza e subjektit ka qenë me studime universitare në Tiranë, si dhe për periudhën tetor - dhjetor në vitin 2014.
3. Shuma prej 290.000 lekësh e shpenzimit për një udhëtim të vajzës së subjektit në Londër nuk duhet të konsiderohet në zërin shpenzime, pasi ky shpenzim është mbuluar me të ardhurat e babait të subjektit, i cili ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga pensioni i tij dhe i bashkëshortes, përveç të ardhurave nga aktiviteti bujqësor e blegtoral. Subjekti ka depozituar edhe dy vërtetime të lëshuara nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë, për të provuar të ardhurat nga pensioni i prindërve, ku për vitet 2004 – 2012, të ardhurat e prindërve nga pensioni kanë qenë në vlerën totale 1.225.945 lekë. Si burim për këtë shpenzim, subjekti ka deklaruar se është mbuluar nga kursimet e prindërve, të ardhurat nga pensioni, ekonomia bujqësore, bletaria dhe vreshtaria.

Subjekti ka shpjeguar: “*Nga përmbajta e dokumentacionit provues në lidhje me pagesën e kontributeve, si të vetëpunësuar në bujqësi nga njëra anë dhe për të ardhurat nga pensioni nga ana tjetër, për prindërit e mi, krijohet dukshëm bindja se ata kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të përballuar një shpenzim në vlerën e 290.000 lekë dhe për pasojë*

² Deklarata noteriale nr. ***, datë 26.4.2013.

Komisioni nuk duhet të kishte përfshirë këtë shumë në zërin 'shpenzime për shkollën e vajzës', në analizën financiare të vitit 2013".

Në lidhje me shpenzimet e udhëtimit sipas TIMS, subjekti ka shpjeguar se në këtë zë të analizës financiare *"nuk duhet të përfshihen shpenzimet e udhëtimit (karburanti)"*, të kryera për shkak të detyrës si gjyqtar i komanduar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, të cilat mbuloheshin nga vetë gjykata. Gjatë vitit 2013 subjekti ka pasur disa gjykime si gjyqtar i deleguar në Gjykatën e Apelit Korçë dhe ka ndjekur itinerarin Gjirokastër-Kakavijë-Kapshticë-Korçë dhe anasjellas, pra, është kthyer brenda ditës dhe në territorin grek thjesht ka kaluar për arsye se udhëtimi ishte më komod.

Në lidhje me shpjegimet e mësipërme subjekti ka paraqitur dokumentacion provues:

- vendime të arsyetuara (4 vendime), dorëzuar sekretares gjyqësore në datën 3.6.2013;
- vendime civile (4 vendime), të dhëna në datën 4.6.2013:
 1. Vendim nr. ***, datë 4.6.2013 (anëtar i trupit gjykues).
 2. Vendim nr. ***, datë 4.6.2013 (kryesues i trupit gjykues).
 3. Vendim nr. ***, datë 4.6.2013 (anëtar i trupit gjykues).
 4. Vendim nr. ***, datë 4.6.2013 (anëtar i trupit gjykues).
 5. Vendim penal nr. ***, datë 4.6.2013 (kryesues i trupit gjykues).
- vërtetim nr. *** prot., datë 31.12.2019, i lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, me të dhëna nga sistemi TIMS;
- vërtetim nr. *** prot., datë 3.1.2020, i Gjykatës së Apelit Korçë;
- dokumentacion për pronësinë e automjeteve tip "Mercedes Benz", me targa *** dhe "Volkswagen Bora", me targa ***.
- vërtetim nr. *** prot., datë 10.1.2020, Arkiva e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, bashkëngjitur të cilit gjenden dokumentet e mëposhtme:

67 fletë nga libri i dorëzimit të vendimeve të arsyetuara të vitit 2013.

Nga të dhënat e sistemit TIMS evidentohen këto udhëtime si kalime hyrje-dalje brenda ditës.

Në lidhje me të ardhurat e prindërve, subjekti ka paraqitur dokumentacion provues, si:

- vërtetim pensioni nr. *** prot., datë 7.1.2020, i DRSSh-së, për z. S. B.;
- vërtetim pensioni nr. *** prot., datë 7.1.2020, i DRSSh-së, për zj. A. B.;
- vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi, datë 30.12.2019, i DRSSh-së, për z. S. B.;
- vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi, datë 30.12.2019, i DRSSh-së, për zj. A. B.;
- vërtetim nr. *** prot., datë 31.12.2019, i Bashkisë Libohovë (bujqësia + blegtori);
- vërtetim nr. *** prot., datë 31.12.2019, i Bashkisë Libohovë (bletari + vreshtari).

Subjekti ka dokumentuar të ardhurat e prindërve nga pensioni për periudhën 2004 – 2012, në vlerë totale 1.225.945 lekë, duke shpjeguar se: *"Nga përmbajta e dokumentacionit provues në lidhje me pagesën e kontributeve, si të vetëpunësuar në bujqësi nga njëra anë dhe për të ardhurat nga pensioni nga ana tjetër, për prindërit e mi krijohet dukshëm bindja se kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të përballuar një shpenzim në vlerën prej 290.000 lekësh dhe për pasojë Komisioni nuk duhet të kishte përfshirë këtë shumë në zërin 'shpenzime për shkollën e vajzës', në analizën financiare të vitit 2013".*

2.7 Arsyetim ligjor dhe analiza e provave

Trupi gjykues shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, duke vlerësuar se provat e paraqitura kishin nivelin e provueshmërisë, duke arritur në konkluzionin se subjekti provoi bindshëm pretendimet në lidhje me shpenzimet e udhëtimeve për arsye pune, si dhe mbulimin e shpenzimit në shumën 290.000 lekë me të ardhurat e prindërve. Duke i reflektuar në analizën financiare për vitet 2013 – 2016 ka rezultuar se për vitin 2013 analiza paraqitet pozitive, ndërsa balanca negative minimizohet për vitin 2014, në shumën prej 44.456 lekësh, për vitin 2015 në shumën 50.443 lekë dhe për vitin 2016, në shumën prej 44.449 lekësh.

- ✓ Për sa më sipër u konkludua se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e depozitave në ABI.

Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016, pas prapësimeve të subjektit

| PERSHKRIMI | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|--|---------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| 1 PASURI | - | - | - | - | 1 041 161 | - | - | - | - | - | - | - | - | 1 600 000 |
| Bkëre automjetet audi A4 viti 2001 nga Gjermania AA555MG | | | | | 1 041 161 | | | | | | | | | |
| 2 DEFTYRIME | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3 PASURI NETO | - | 0 | 0 | 0 | 1 041 161 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 600 000 |
| 4 TË ARDHURA | 576 843 | 1 015 385 | 1 575 745 | 1 092 950 | 1 173 208 | 1 307 708 | 1 474 778 | 1 593 126 | 1 607 571 | 1 669 631 | 2 138 742 | 2 529 427 | 2 100 748 | 4 038 105 |
| Të ardhura nga paga Subjekti të dokumentuara | 576 843 | 1 015 385 | 1 125 745 | 1 092 950 | 1 173 208 | 1 200 540 | 1 241 532 | 1 211 766 | 1 208 827 | 1 254 312 | 1 332 389 | 1 461 183 | 1 470 163 | 1 480 893 |
| Të ardhura bashkëshortja | - | - | - | - | - | 107 168 | 233 246 | 381 360 | 398 744 | 415 319 | 516 353 | 477 859 | 480 406 | 482 316 |
| Të ardhura nga dhuratat e të afërmeve vajzës së SR për fillimin e shkollës | | | | | | | | | | | 290 000 | 590 385 | | |
| Të ardhura nga shija e mullinës | | | 450 000 | | | | | | | | | | | |
| 5 SHPENZIME | 375 456 | 379 869 | 438 228 | 576 132 | 708 640 | 608 831 | 649 042 | 732 279 | 696 877 | 973 852 | 1 191 867 | 1 534 278 | 1 577 749 | 1 762 248 |
| Shpenzime jetese | 375 456 | 375 456 | 438 228 | 438 228 | 546 480 | 546 480 | 546 480 | 546 480 | 546 480 | 564 096 | 564 096 | 824 993 | 672 828 | 705 276 |
| Shpenzime jetese vajza në Tiranë (2014-2016) | | | | | | | | | | | | 60 000 | 240 000 | 300 000 |
| TIMS | 4 413 | 0 | 6 654 | 30 910 | 23 351 | 57 562 | 7 549 | 19 147 | 278 506 | 206 521 | 6 353 | 26 704 | 87 380 | |
| Shpenzime për shkollën e djalit | | | | | 39 000 | 45 000 | 47 000 | | | | | | 26 500 | 67 100 |
| Shpenzime për shkollën e vajzës | | | | | | | | | | 290 000 | | 511 682 | 611 717 | 602 493 |
| Shpenzime mobilimi | | | 131 250 | 131 250 | | | 131 250 | 131 250 | 131 250 | 131 250 | 131 250 | | | |
| 6 LIKUIDITETE NË FILLIM TË VITIT | 0 | 0 | 0 | 752 644 | 1 158 950 | 411 289 | 1 122 733 | 1 949 224 | 2 622 624 | 3 355 393 | 4 015 549 | 4 872 255 | 5 911 860 | 6 485 303 |
| Gjendja e Bugarisë Societe Generale Subjekti | - | - | - | - | - | - | - | 44 159 | 22 591 | 77 291 | 30 524 | 60 398 | 32 256 | - |
| Kursimet në emër të vajzës | | | | | | | | | | | | | 590 385 | 673 328 |
| Gjendja e Bugarisë ABI Bank bashkëshortja | | | | | | | | | | | | | | |
| Gjendja e Bugarisë RBAL subjekti | | | 2 644 | 8 950 | 11 289 | 22 728 | | | | | | | | |
| Gjendja e Bugarisë Tirana Bank bashkëshortja | | | | | | | | 33 | 78 102 | 85 025 | 11 857 | 901 | | |
| Gjendje CASH | | | 750 000 | 1 150 000 | 400 000 | 1 100 000 | 1 900 000 | 2 600 000 | 3 200 000 | 3 900 000 | 4 800 000 | 2 288 318 | 787 338 | |
| 7 LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT | 0 | 0 | 752 644 | 1 158 950 | 411 289 | 1 122 733 | 1 949 224 | 2 622 624 | 3 355 393 | 4 015 549 | 4 872 255 | 5 911 860 | 6 485 303 | 7 205 608 |
| Depozite ALPHA BANK hapur në 30.12.2014 | | | | | | | | | | | | 3 000 000 | 3 000 000 | 3 000 000 |
| Depozite ABI Bank 31.12.2015 | | | | | | | | | | | | | 2 000 000 | 2 700 000 |
| Gjendja e Bugarisë Societe Generale Subjekti | | | | | | | 44 159 | 22 591 | 77 291 | 30 524 | 60 398 | 32 256 | | |
| Kursimet në emër të vajzës | | | | | | | | | | | | | 590 385 | 673 328 |
| Gjendja e Bugarisë RBAL subjekti | | | 2 644 | 8 950 | 11 289 | 22 728 | | | | | | | | |
| Gjendja e Bugarisë Tirana Bank bashkëshortja | | | | | | | | 33 | 78 102 | 85 025 | 11 857 | 901 | | |
| Gjendje CASH (deklarata e pasurisë) | | | 750 000 | 1 150 000 | 400 000 | 1 100 000 | 1 900 000 | 2 600 000 | 3 200 000 | 3 900 000 | 4 800 000 | 2 288 318 | 787 338 | 497 020 |
| DIFERENCA | 201 387 | 635 516 | 384 873 | 110 512 | 171 067 | -12 567 | -755 | 187 447 | 177 925 | 35 623 | 90 169 | -44 456 | -50 443 | -44 449 |

3. Llogari rrjedhëse në vlerën 489 lekë, në datën 23.1.2017, në NBG. Pjesa takuese : 100 %.

NBG-ja³ konfirmon se subjekti është klient i kësaj banke dhe se ka hapur llogari page në lekë në datën 2.12.2015, në të cilën i kalon paga si kryetar i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

- ✓ Nga verifikimi i kryer deklarimi i subjektit përputhet me të dhënat e marra nga NBG-ja.

4. Gjendje cash, me shumë 5.000 USD. Këto likuiditete zotërohen në bashkëpronësi me bashkëshorten.

Si burim krijimi, referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2016, subjekti ka deklaruar gjendjen cash në shumën prej 1.000.000 lekë, nga të ardhurat e kursyera nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

4.1 Analiza e fakteve dhe provave lidhur me këtë pasuri

Referuar analizës financiare të vitit 2016, vërehet se subjekti në fund të vitit 2016 ka pasur të disponueshme shumën prej 702.174 lekësh për krijimin e gjendjes cash në shumën prej 5.000 USD, e deklaruar gjendje cash në datën 27.1.2017 (data e dorëzimit të deklaratës “Vetting”);

³ Shkresa nr. ***, datë 13.2.2018.

shuma prej 5.000 USD konvertohet në shumën prej 642.000 (referuar kursit mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për muajin janar të vitit 2017).

- ✓ Për sa më sipër ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e gjendjes *cash* në datën 27.1.2017, në shumën 5.000 USD.

5. Automjet tip “Audi”, viti i prodhimit 2001, me vlerë 3.800 euro + 231.064 lekë, blerë sipas faturës tatimore datë 30.7.2007. Pjesa takuese: 100% nga subjekti.

Burimi i krijimit: për blerjen e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: (1) të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Nisan Patrol”, në vlerën prej 450.000 lekësh; (2) dhe kursimet familjare.

5.1 Analiza e fakteve dhe e provave

DPSHTRr-ja⁴ ka informuar se nga verifikimet e bëra në Arkivën Kombëtare Elektronike të mjeteve rezulton se subjekti ka në pronësi automjetin “Audi” dhe se ky mjet figuron i regjistruar për herë të parë në datën 30.9.2015, në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Gjirokastrë.

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Gjirokastrë, me shkresën nr. *** prot., datë 3.1.2019, ka dërguar dosjen e plotë të automjetit tip “Audi”.

Nga verifikimi i materialeve të kësaj dosjeje konstatohet se: (i) automjeti tip “Audi A4”, viti i prodhimit 2001, është blerë në Gjermani, në vlerën 3.800 euro, nëpërmjet faturës së datës 30.7.2007, konfirmuar dokumenti me vërtetimin noterial me nr. *** rep., datë 21.8.2007; (ii) referuar deklaratës doganore në datën 22.8.2007, subjekti e ka zhdoganuar këtë automjet dhe ka paguar në total detyrimet doganore dhe tatimore në vlerën prej 231.064 lekësh; (iii) pas zhdoganimit të automjetit, subjekti ka kryer procedurat përkatëse në DRSHTRr-në Gjirokastrë.

Lidhur me automjetin tip “Audi A4”, nga hetimi i kryer konstatohet se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRr-ja dhe DRSHTRr-ja Gjirokastrë.

Lidhur me mundësinë e kryerjes së pagesës për blerjen e automjetit në vitin 2007, Komisioni referuar analizës financiare të kryer arriti në konkluzionin se subjekti ka pasur aftësi paguese për blerjen e automjetit.

6. Apartament banimi në posedim me sip. 85.5 m², me vlerë 800.000 lekë, i blerë sipas kontratës së shitblerjes⁵ në datën 25.9.2003, në emër të z. S. B., i regjistruar në ZVRPP-në Gjirokastrë, në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 10.2.2004.

6.1 Analiza e fakteve dhe provave

Komisioni ka verifikuar deklaratimet e subjektit të bëra ndër vite lidhur me këtë pasuri dhe nga verifikimi i deklaratës fillestare të pasurisë së vitit 2003 vërehet se subjekti e ka deklaruar këtë pasuri të regjistruar në emër të familjarëve të tij, apartament banimi i papërfunduar, me vlerë 800.000 lekë, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 10.2.2004, me nr. pasurie ***, ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastrë, blerë nga babai i subjektit, z. S. B., sipas kontratës

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 20.2.2018.

⁵ Kontratë nr. ***, datë 25.9.2003.

noteriale nr. ***, datë 25.9.2003. Si burim krijimi të kësaj pasurie, babai i subjektit ka deklaruar se janë kursimet e tij dhe të bashkëshortes.

Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se apartamenti në momentin e blerjes ishte karabina, me çmim blerjeje 800.000 lekë dhe vlera e investuar për përfundimin e punimeve ka qenë në shumën 930.921 lekë, duke paraqitur edhe preventivin e punimeve për objektin. Komisioni, referuar udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2003, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit ‘k’...”, ka konstatuar se për apartamentin kostoja e ndërtimit për vitin 2003 ka qenë rreth 2.074.000 lekë (85m² x 24.400).

Referuar kontratës noteriale të shitblerjes konfirmohet se në datën 25.9.2003, babai i subjektit ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., pasurinë e llojit apartament banimi me sip. 85.5 m², në vlerën prej 800.000 lekësh, ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastër.

ASHK-ja, Drejtoria Vendore Gjirokastër⁶ ka dërguar referencën e plotë të kësaj pasurie.

Nga verifikimi i dokumentacionit të kësaj pasurie konfirmohet se z. S. B., nëpërmjet kontratës noteriale të datës 25.9.2003, ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., me vlerë 800.000 lekë pasurinë e llojit apartament me sip. 85.5 m², nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***.

Pasuria në origjinë figuron me nr. hipotekor ***, datë 30.1.2003, me pronar shoqërinë “****” sh.p.k., nga ku rezulton se objekti është i kolauduar.

Duket se në lidhje me gjendjen e kësaj pasurie në momentin e blerjes si karabina ka mospërputhje me dokumentacionin e administruar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Gjirokastër (si objekt i kolauduar).

Nisur nga fakti që kjo pasuri zotërohet nga subjekti që prej vitit 2005, duke e deklaruar si banesë këtë apartament, trupi gjykues ka vlerësuar se referuar pikës 14, të nenit 3, si edhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, z. S. B. (babai i subjektit) bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

Trupi gjykues vlerësoi se në përputhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, pikat 11, 19 të nenin 3 dhe nenin 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Banushi, ka pasur detyrimin jo vetëm ta deklarojë këtë pasuri në përdorim në deklaratën “Vetting”, por edhe të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor lidhur me burimin e krijimit.

Gjate hetimit administrativ, subjekti u pyet nga Komisioni për burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti. Subjekti ka deklaruar se: “...si burim kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e 90 krerëve të bagëtive të imëta dhe 3 lopëve, si dhe të ardhurat nga bletaria dhe vreshtaria”.

Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se nuk janë mbajtur të dhëna të sakta në atë periudhë, duke sjellë një situatë financiare të përafërt për fitimin nga aktiviteti blegtoral i babait për periudhën 1992 – 2003⁷.

⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 6.11.2019.

⁷ Referojuni pyetësorit të datës 4.2.2019.

Në kushtet kur ky aktivitet ka qenë i familjes bujqësore, i paformalizuar dhe nuk ka ndonjë dokument zyrtar për të provuar të ardhurat, subjekti ka dorëzuar deklarata noteriale të shitjes së bagëtive në vitin 2003 te disa kasapë të zonës. Gjithashtu, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues vërtetimin nr. *** prot., datë 8.4.2019, të lëshuar nga Bashkia Libohovë, Sektori i Shërbimit Bujqësor Blegtoral dhe Mjedisor, si dhe vërtetim nga mjeku veteriner z. B. B., për të provuar ekzistencën e këtij aktiviteti.

Babai i subjektit, z. S. B., nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 15.2.2019, ndër të tjera ka deklaruar blerjen e këtij apartamenti.

Referuar udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2003, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit ‘k’...”, konstatohet se çmimi i shitjes së banesave për rrethin Gjirokastrë, në vitin 2003 është 34.188 lekë/m².

Nisur nga fakti që kjo banesë është blerë nga babai i subjektit, kur pallati ka qenë i hipotekuar dhe i kolauduar, vlera e saj në tregun e lirë në momentin e blerjes duhet të ketë qenë rreth 2.923.074 lekë (85.5 m² x 34.188 lekë).

6.2 Konstatimet e Komisionit

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje duket se:

- i. ky apartament është blerë i përfunduar dhe jo në gjendje karabina;
- ii. vlera e shitjes së tij në kontratën e shitblerjes nuk përfaqëson vlerën reale të blerjes;
- iii. babai i subjektit nuk justifikon me burime të ligjshme blerjen e kësaj pasurie në vitin 2003 në shumën prej 2.923.074 lekësh.

Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjekti iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën në lidhje me konstatimet për këtë pasuri.

6.3 Qëndrimi i mbajtur nga subjekti pas kalimit të barrës së provës

i. Në lidhje me apartamentin e blerë në gjendje karabina, subjekti shpjegoi se *apartamenti i banimit me sip. 85.5 m², në qytetin e Gjirokastrës, përbën një investim tërësisht personal të babait të tij, i cili realisht e ka blerë këtë apartament në gjendje karabina, ashtu sikundër është deklaruar prej subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, si dhe në deklaratën “Vetting”. Çdo provë shkresore e nxjerrë nga autoritetet shtetërore kompetente nuk duhet marrë në konsideratë dhe nuk duhet të krijojë asnjë lloj dyshimi për të kundërtën, për sa kohë bie ndesh me realitetin faktik të gjendjes karabina të këtij apartamenti në momentin e blerjes nga babai. Në këtë kuptim, aktit të kolaudimit nuk mund t’i jepet asnjë vlerë provuese në drejtim të vërtetimit të faktit që ky apartament ka qenë i përfunduar, pasi edhe sot, pavarësisht se ka kaluar një kohë shumë e gjatë prej 16 vjetësh, blerësi M. T., banor i të njëjtit kat, përballë hyrjes së babait të subjektit, e ka apartamentin e blerë prej tij në gjendje karabina. Provat që paraqet në këtë drejtim, kontrata e shitblerjes së këtij shtetasi dhe fotografitë e apartamentit të blerë prej tij (ku duken qartë se punimet janë të papërfunduara, konkretisht: muret e ngritura me tulla të kuqe e të pasuvatuara, dyshemeja e pashtruar, mungesa e dyerve dhe dritareve, ballkonet pa kangjella, pa instalime elektrike dhe hidraulike etj.), duhet të krijojnë bindjen e plotë të komisionerët për vërtetësinë e deklarimeve të subjektit se apartamenti i blerë prej babait të tij ka qenë në gjendje karabina. Kjo gjendje faktike e punimeve të ndërtimit të apartamentit të blerë nga shtetasi M. T. është në përputhje me konceptin ligjor të karabinasë, sipas kuptimit që rezulton nga ligji që ka qenë në fuqi në momentin e transaksionit dhe që më*

konkretisht është ligji nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, në të cilin është përcaktuar se: “karabina është objekti i ndërtuar plotësisht në volum dhe në formë, sipas kushteve urbanistike të miratuara për konstruksionin dhe muraturën e plotë të objektit”.

Dokumentacioni provues

Për të provuar faktin e blerjes në gjendje karabina të apartamentit, subjekti ka paraqitur:

- deklaratë noteriale nr. ***, datë 9.1.2020, me deklarinimet e shtetasit E. D., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k.;
- foto të fasadës së pallatit, ku evidentohet qartë se ngjyrat e duraluminit të dritareve dhe të dyerve janë të ndryshme, çka tregon se ato nuk janë vendosur nga firma ndërtuese në kohën e ndërtimit të pallatit, para bërjes së aktkolaudimit, por janë vendosur më vonë nga vetë blerësit e këtyre apartamenteve. Subjekti ka paraqitur këto foto për të provuar se apartamentet nuk janë dorëzuar të përfunduara plotësisht “me çelësa në dorë” te blerësit, por janë dorëzuar karabina dhe përfundimi total i punimeve është bërë prej vetë banorëve të këtyre apartamenteve, pas blerjes së tyre nga firma ndërtuese;
- foto të një apartamenti në pallat, i cili ende rezulton i papërfunduar dhe është blerë nga blerësi në të njëjtën kohë dhe se ai thjesht ka vendosur dritare të vjetra, por nuk e ka përfunduar ende këtë apartament të blerë karabina.

ii. Në lidhje me çmimin e blerjes subjekti shpjegoi se *në kuptim të neneve 663, 676 dhe 607 të Kodit Civil, çmimi në kontratën e shitjes përbën një kusht që përcaktohet mbi bazën e vullnetit të ndërsjellë të palëve të kësaj kontrate. Çmimi i përcaktuar në kontratën e shitjes me nr. ***, datë 25.9.2003, përfaqëson pikërisht vlerën e shitjes së sendit, apartamentit, të përcaktuar mbi bazën e vullnetit reciprok të palës shitëse dhe palës blerëse.*

Subjekti ka shpjeguar se babai i tij e ka blerë realisht këtë banesë në gjendje karabina për çmimin e deklaruar prej 800.000 lekësh. Në të njëjtat kushte me të kanë blerë apartamentin karabina për të njëjtin çmim edhe disa banorë të tjerë të pallatit. Subjekti ka shpjeguar se babai i tij ka pasur të ardhura nga aktiviteti i tij si i vetëpunësuar në bujqësi dhe blegtori dhe se disa kohë para se të blinte këtë apartament kishte shitur aktivitetin e tij blegtoral dhe me ato të ardhura kishte blerë shtëpinë në gjendje karabina nga ndërtuesi, si dhe kishte përfunduar punimet e brendshme të saj me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti i tij blegtoral. Subjekti shpjegoi se babai i tij ka qenë më parë (në vitet ‘90) ndërtues/muratur dhe se një pjesë të madhe të punimeve në këtë apartament i kishte mbuluar vetë.

Dokumentacioni provues

Për të provuar shpjegimet e tij subjekti ka paraqitur si provë:

- kontratë shitje nr. ***, datë 22.9.2003, me blerës A. M.;
- kontratë shitje nr. ***, datë 25.9.2003, me blerës M. Dh., të cilat referojnë të njëjtin çmim blerjeje prej 800.000 lekësh dhe e blerë në të njëjtat kushte me ato të babait të subjektit të rivlerësimit dhe në të njëjtin objekt.
- kontratë shitje nr. ***, datë 28.10.2003, me blerës M. dhe L. T., të cilët ia kanë blerë pronares së truallit, znj. Q. B., ku evidentohet e njëjta marrëdhënie lidhur me çmimin e blerjes. Po ashtu, subjekti ka paraqitur foto ku duket se ky apartament është ende në gjendje të papërfunduar.

iii. Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament subjekti, për të provuar burimin e krijimit të pasurisë apartament shpjegoi dhe dokumentoi të ardhurat e prindërve nga blegtoria, vreshtaria dhe bletaria për periudhën 1991 – 2002, në total në shumën 4.496.120 lekë.

Subjekti, pas prapësimeve shpjegoi se *të ardhurat totale të prindërve nga blegtoria, vreshtaria dhe bletaria për periudhën 1991 – 2002 kanë qenë në shumën 4.496.120 lekë. Kjo gjendje e të ardhurave të realizuara nga prindërit e subjektit për këtë periudhë kohore është tregues i mundësisë së tyre financiare, jo vetëm për realizimin e blerjes së apartamentit të banimit në vlerën reale të përcaktuar në kontratën e shitblerjes, por edhe në vlerën së cilës i referohet Komisioni, sipas udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2003.*

Dokumentacioni provues

1. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 11.9.2009, pasuria arë me sip. 968 m², me nr. ***, z. k.***, përfituar nga ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.
2. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 11.9.2009, pasuria arë me sip. 2.125 m², me nr. ***, z. k. ***, përfituar nga ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.
3. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 11.9.2009, pasuria arë me sip. 2.410 m², me nr. ***, z. k. ***, përfituar nga ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.
4. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 11.9.2009, pasuria arë me sip. 1.189 m², me nr. ***, z. k. ***, përfituar nga ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.
5. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 11.9.2009, pasuria arë me sip. 2.060 m², me nr. ***, z. k. ***, përfituar nga ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.
6. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 20.1.2010, pasuria arë me sip. 500 m², nr. ***, z. k. ***, përfituar nga ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.
7. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 20.1.2010, pasuria arë me sip. 420 m², me nr. ***, z. k. ***, përfituar nga ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.
8. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 20.1.2010, pasuria arë me sip.7.800 m², me nr. ***, z. k. ***, përfituar nga ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.
9. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 20.1.2010, pasuria arë me sip. 2.400 m², me nr. ***, z. k. ***, përfituar nga ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.
10. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 20.1.2010, pasuria truall me sip. 300 m² (banesa aktuale), me nr. ***, z. k. ***, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.
11. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 12.5.2009, pasuria truall me sip. 250 m², me nr. ***, z. k. ***, kthyer me vendimin nr. 138, datë 25.8.1994, të KKKP-së ish-pronarëve, Gjirokastër, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.

12. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 12.5.2009, pasuria truall me sip. 1.000 m², me nr. ***, z. k. ***, kthyer me vendimin nr. ***, datë 25.08.1994 të KKKP-së ish-pronarëve, Gjirokastrë, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.
13. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 12.5.2009, pasuria truall me sip. 570 m², me nr. ***, z. k. ***, kthyer me vendimin nr. 526, datë 16.4.1998, të KKKP-së ish-pronarëve, Gjirokastrë, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.
14. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 4.6.2015, pasuria pemëtore me sip. 450 m², me nr. ***, z. k. ***, në posedim të pandërprerë dhe kthyer me vendim të KKKP-së ish-pronarëve, Gjirokastrë, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.
15. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 4.6.2015, pasuria truall me sip. 227 m², me nr. ***, z. k. ***, në posedim të pandërprerë dhe kthyer me vendim të KKKP-së ish-pronarëve, Gjirokastrë, bashkëngjitur harta treguese e regjistrimit.
16. Fotografi për kosheret e bletëve dhe vreshtat, në pronësi të babait të subjektit.
17. Vërtetim pensioni nr. *** prot., datë 7.1.2020, i DRSSH-së, për z. S. B.
18. Vërtetim pensioni nr. *** prot., datë 7.1.2020, i DRSSH-së, për znj. A. B.
19. Vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi, datë 30.12.2019, i DRSSH-së, për z. S. B.
20. Vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi, datë 30.12.2019, i DRSSH-së, për zj. A. B.
21. Vërtetim nr. *** prot., datë 31.12.2019, i Bashkisë Libohovë (bujqësi + blegtori).
22. Vërtetim nr. *** prot., datë 31.12.2019, i Bashkisë Libohovë (bletari + vreshtari).
23. Vërtetim datë 5.1.2020, i Kryeplakut të fshatit Stegopol.

6.4 Analiza e provave dhe fakteve

Në lidhje me dyshimin e ngritur nga Komisioni se apartamenti i z. S. B. është blerë i përfunduar në vlerën 2.923.074 lekë, sipas vlerave në tregun e lirë në momentin e blerjes, dhe jo në gjendje karabina, subjekti paraqiti prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën.

Komisioni vlerësoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij dhe në përfundim arsyeton se babai i tij e ka blerë apartamentin në gjendje karabina dhe ka kryer punimet për përfundimin e tij, të cilat, sipas deklarimeve të subjektit shkojnë në total në vlerën 1.900.000 lekë. Fakti se z. S.B. e ka blerë objektin dhe më tej ka vazhduar me ndërtimin dhe përfundimin e tij dhe se të ardhurat e përdorura e kanë burimin nga një gjendje *cash* kursimesh të tij nga shitja e aktivitetit blegtoral, si dhe fakti se edhe fqinjë të tjerë e kanë blerë shtëpinë në të njëjtat kushte dhe me çmime të ngjashme, krijon bindjen se deklaratimet e subjektit janë të vërteta dhe pasqyrojnë gjendjen reale. Po ashtu, mbështetur në provat e administruara duket qartë se pallati është ndërtuar sipas interesave të secilit banor (referuar dritareve, grilave dhe dyerve të jashtme) dhe se ende ka një apartament në gjendje të papërfunduar, çka shton bindjen se ky pallat është shitur në gjendje karabina. Po ashtu, fakti se vlera prej 1.900.000 lekësh e përdorur dhe e deklaruar nga subjekti për këtë apartament ka qenë e disponueshme nga z. S. B., paraprakisht heq dyshimet se subjekti mund të jetë përpjekur për të ndarë vlerën e shpenzuar për këtë apartament, me qëllim justifikimin e burimeve të ligjshme.

Trupi gjykues, në vlerësim dhe analizim mes vlerës së deklaruar prej 1.900.000 lekësh dhe vlerës prej 2.074.000 lekësh (85 m² * 24.400), e cila është vlera sipas koston së ndërtimit të

përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2003, krijoi bindjen se vlera e deklaruar nga subjekti, duke marrë në konsideratë edhe provat e paraqitura prej tij, është reale dhe duhet pranuar.

Lidhur me të ardhurat e babait të subjektit, Komisioni arriti në përfundimin se të ardhurat *neto* të përfituara nga vetëpunësimi në bujqësi e dhe blegtori nuk janë realisht të matshme. Referuar legjislacionit në fuqi, duke filluar nga viti 1994 e deri më sot, objekt taksimi është vetëm sipërfaqja e tokës që zotëron dhe jo të ardhurat që gjeneron toka bujqësore apo prodhimet blegtorale. Fermerët nuk deklarojnë të ardhura lidhur me produktet e tyre. Pas vitit 2012 në legjislacion u përfshi skema e rimbursimit të TVSh-së për fermerin, nëpërmjet të cilës fermerët që kërkonin rimbursim të TVSh-së duhet të deklaronin shitjet e tyre.

Si i vetmi rregullim ligjor për të vetëpunësuarit në bujqësi dhe blegtori është ai i pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore në mënyrë vullnetare, në mënyrë që të mos humbasin vitet e punës. Tarifa e përcaktuar për këtë kategori llogaritet sipas zonave ku ata ushtrojnë aktivitetin e tyre, p.sh., zonat malore paguajnë më pak se ato të zonave fushore, pasi ato gjenerojnë më pak të ardhura se zonat fushore⁸. Sipas legjislacionit në fuqi të vetëpunësuarit në bujqësi dhe blegtori duhet të plotësojnë disa kushte për t'u siguruar si të vetëpunësuar, të cilat janë:

- të kenë tokë në pronësi ose në përdorim, sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", ose akt noterial që vërteton tjetërsimin e pronës (p.sh., qiramarrje etj.);
- të ushtrojnë aktivitetet bujqësor ose blegtoral;
- të jenë banorë në rrethin që kanë tokën dhe ushtrojnë aktivitetin.

Nga hetimi ka rezultuar se babai i subjektit, z. S. B., ka paguar detyrimet lidhur me sigurimet shoqërore, ka pasur tokë në pronësi dhe ka ushtuar aktivitet bujqësor dhe blegtoral, si dhe ka paraqitur dokumentacion provues se ka blerë dhe shitur bagëti. Gjithashtu, ka paraqitur dokumentacion provues se ka pasur vreshta të mbjella me rrush, si dhe aktivitet bletarie.

Shuma e kontributeve të paguara i korrespondon vlerës së pagës minimale, por i tillë ka qenë edhe vetë legjislacioni në fuqi. Gjithashtu, duhet konsideruar edhe fakti se familjet bujqësore shpenzimet e jetesës i kanë më të vogla se familjet e tjera që llogariten nga INSTAT-i, pasi koston e ushqimit e prodhojnë vetë.

Në përfundim, Komisioni krijoi bindjen se babai i subjektit ka realizuar aktivitetin e tij në bujqësi, blegtori e bletari, duke realizuar të ardhura nga ky aktivitet dhe se ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2003.

Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues, mbështetur në faktet më sipër krijoi bindjen se deklaratimet e subjektit janë të sakta dhe përputhen me situatën gjatë hetimit administrativ. Babai i subjektit ka pasur mundësi financiare për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2003.

Pasuri të deklaruara veçmas nga personi lidhur, bashkëshortja e subjektit

7. Apartament banimi, në pronësi të bashkëshortes së subjektit, i përfituar me vendimin nr. ***, datë 21.4.2016, për lëshimin e dëshmisë testamentare. Apartamenti me sip. 67.6 m² ka një shtesë anësore të papërfunduar me sip. 13 m², sipas dokumentacionit tekniko-ligjor të

⁸ Për zonat fushore vlera është 9.600 lekë në tremujorë dhe për zonat malore vlera është 7.350 lekë në tremujor, sipas ISSH-së.

<http://lexo.com.al/të-vetëpunësuarit-në-bujqësi-sa-duhet-të-paguajnë-për-të-marrë-pension/>

lëshuar nga Bashkia Gjirokastrë, me vlerë 1.600.000 lekë. Pjesa takuese: 100 % bashkëshortja e subjektit.

Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2016 subjekti ka deklaruar apartament banimi në emër të bashkëshortes, të fituar me testament nga babai i saj, z. F. M., pasuri e blerë prej tij me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 12.6.1999, si dhe shtesë anësore me sip. 13 m², me leje ndërtimi.

7.1 Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

ZVRPP-ja Gjirokastrë ka informuar se në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, figuron e regjistruar pasuria: (i) e llojit apartament banimi me sip. 67 m², e regjistruar me nr. ***, datë 16.6.2016; dhe (ii) e llojit shtesë anësore me sip. 13 m², e regjistruar me nr. ***, datë 7.7.2016.

Nga analizimi i dokumentacionit noterial konstatohet se shtetasi F. M. (babai i bashkëshortes së subjektit) ka blerë apartamentin me sip. 67.6 m², të ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastrë. Në datën 25.1.2006 z. F.M. ka shprehur vullnetin e tij me testamentin nr. *** regj., duke ia lënë këtë pasuri vajzës së tij, znj. M. B. (M.). Në datën 21.4.2016, nëpërmjet aktit noterial nr. *** është mbajtur procesverbali për çeljen e testamentit dhe është përpiluar vendimi për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare me nr. ***, datë 25.1.2006.

ASHK-ja, Drejtoria Vendore Gjirokastrë⁹, ka dërguar referencën e plotë të kësaj pasurie. Nga verifikimi i dosjes konfirmohet se pasuria e llojit apartament banimi me sip. 67.6 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në emër të bashkëshortes së subjektit është përfitur bazuar në dokumentin *dëshmi e trashëgimisë testamentare* me nr. ***, datë 21.4.2016. Në datën 16.6.2016 është regjistruar apartamenti në emër të bashkëshortes.

7.2 Hetimi lidhur me shtesën anësore me sip. 13 m²

Nga hetimi ka rezultuar se në emër të bashkëshortes së subjektit figuron pasuria e llojit shtesë anësore me sip. 13 m², pjesë e pandashme e apartamentit, e përfitur me dëshminë e trashëgimisë testamentare nr. ***, datë 21.4.2016, e regjistruar me nr. hipotekor ***, datë 7.7.2016, z. k. ***.

Referuar dokumentacionit të administruar në dosje të dërguar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Gjirokastrë, konstatohet se: (i) leja e ndërtimit për këtë shtesë është dhënë me vendimin nr. 5, datë 17.11.2005, të KRRT-së, Bashkia Gjirokastrë; (ii) procesverbali i kolaudimit të këtij objekti është përpiluar në datën 30.8.2006; dhe (iii) certifikata e përdorimit në emër të të ndjerit, z. F. M. etj., lëshuar në datën 25.6.2016, nga Bashkia Gjirokastrë.

Kjo pasuri figuron e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 7.7.2016, në pronësi të bashkëshortes së subjektit, znj. M. B.

Lidhur me shtesën anësore Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit, pasi referuar aktit të kolaudimit të përpiluar në datën 30.8.2006, shtesa duhet të ishte e përfunduar dhe mospërputhja qëndron në deklaratën “Vetting” ku shtesa anësore është cilësuar nga subjekti i rivlerësimit si e papërfunduar, si dhe iu kërkuan shpjegime për mënyrën se si e ka fituar bashkëshortja këtë pasuri.

⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 6.11.2019.

7.3 Qëndrimi i subjektit

Në prapësimet e tij subjekti shpjegoi se: “...shtesa anësore është fituar nga bashkëshortja në rrugë trashëgimore nga i ati, nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë testamentare nr. ***, datë 21.4.2016.

Në këtë rast, momenti i regjistrimit të kësaj shtese, në kuptim edhe të vendimit unifikues nr. 1, datë 6.1.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin është dhënë konkluzioni se: ‘...sipas legjislacionit shqiptar, sistemi i regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk ka efekt krijues, por thjesht publikues, njohës, pasi janë aktet bazë mbi të drejtat reale të pronësisë që krijojnë, ndryshojnë apo mbarojnë të drejtat përkatëse dhe jo regjistrimi i akteve.’, nuk mund të konsiderohet si moment i krijimit të kësaj pasurie, por, si i tillë duhet të konsiderohet momenti i përfundimit të ndërtimit të saj nga ana e trashëgimlënësit, të ndjerit F. M., i cili ka qenë i pajisur me leje ndërtimi nga organet kompetente për realizimin e kësaj shtese.

Për sa i përket faktit të deklaruar në deklaratën ‘Vetting’, se kjo shtesë është ‘e papërfunduar’, sqarohet se termi “e papërfunduar” është përdorur prej meje, pasi perceptimi që kisha në momentin e deklarimit për gjendjen faktike të punimeve, lidhej pikërisht me mospërfundimin e tyre, pasi nuk kishin përfunduar plotësisht punimet e brendshme, sepse kishin mbetur pa u shtruar ende pllakat e dyshemesë”.

7.4 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosje, të dokumentacionit provues dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti, konstaton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka përfituar nëpërmjet trashëgimisë testamentare me nr. ***, datë 21.4.2016, apartamentin e banimit me sip. 67.6 m².

Në datën 16.6.2016 ky apartament është regjistruar në emër të bashkëshortes së subjektit, mbështetur në dëshminë e trashëgimisë testamentare nr. ***, datë 21.4.2016. Së bashku me apartamentin është regjistruar edhe shtesa anësore me sip. 13 m². Nga hetimi ka rezultuar se shtesa anësore me sip. 13m² ka qenë pjesë përbërëse e pasurisë apartament banimi me sip. 67.6 m², dhe ka ekzistuar në momentin e çeljes se dëshmisë së trashëgimisë testamentare nr. ***, datë 21.4.2016, pasi është ndërtuar me lejen e ndërtimit të lëshuar me vendimin nr. 5, datë 17.11.2005, të lëshuar nga KRRT-të, Bashkia Gjirokastrë, por ajo nuk ishte pjesë e dëshmisë së trashëgimisë testamentare. Procedura e regjistrimit të kësaj prone në ZVRPP-në Gjirokastrë është kryer nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

- Për sa më sipër dhe më konkretisht, vërehet se nga analizimi i procesverbalit të çeljes së testamentit dhe nga vendimi i dëshmisë së trashëgimisë testamentare konstatohet se nuk është cilësuar se znj. M. B. trashëgon me testament pasurinë shtesë anësore me sip. 13 m². Pavarësisht se pasuria mund të ketë qenë në ndërtim e sipër apo e përfunduar, çmohet se nuk ka arsye që ndalon testatorin të shprehte vullnetin e tij edhe për këtë pasuri, pavarësisht fazës në të cilën ajo ndodhej. Nga ana tjetër, në kushtet që nuk provohet se testatori ta ketë lënë në testament këtë pasuri, kurrësi nuk mund të merret apriori se si një shtesë e pandashme e një pasurie mund të jetë fituar me testament, duke qenë se faktikisht me këtë mënyrë fitimi është fituar vetëm pasuria bazë.

Ky arsyetim vjen si rrjedhojë edhe referuar kuadrit ligjor se: “Fitimi i një pasurie sipas mënyrave të parashikuara në Kodin Civil, neni 191 e në vijim, ku përfshihet fitimi me

trashëgimi, testament, dhurim, etj., duke mos lënë vend për interpretim për shkak se çdo marrëdhënie pronësore fitohet në mënyrë taksative, të shkruar, të shprehur me vullnet të lirë, të nënshkruar, të vërtetuar sipas parashikimeve të ligjit 'Për noterinë' dhe si finalizim i saj realizohet vetëm tjetërsimi i pasurisë në organin përkatës ish-ZVRPP-së, me shënimin përkatës mbi bazë të të cilës pasuria është fituar.”

Për sa më sipër arsyetuar, Komisioni vlerëson se regjistrimi i sip. 13 m² të shtesës anësore në emër të bashkëshortes së subjektit nuk është kryer në formë të rregullt ligjore, por nga vlerësimi i provave dhe fakteve arsyetohet se lidhur me këtë pasuri të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur ndonjë pretendim nga trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit, F. M. Gjithashtu, ajo është një pjesë integrale e lidhur me apartamentin ekzistues dhe lidhet me marrëdhëniet e familjes së prindërve të bashkëshortes së subjektit.

Në vlerësim të sa më sipër, Komisioni çmon se mënyra e fitimit të kësaj pasurie është përshkruar nga subjekti i rivlerësimit në mënyrë të pasaktë, si dhe ka mbetur në nivel deklarativ, pasaktësi kjo që në vlerësimin tërësor të çështjes së rivlerësimit për këtë subjekt, nuk mund të përbëjë shkak për shkarkimin e tij.

8. Llogari rrjedhëse në ABI, në emër të bashkëshortes së subjektit, me burim të ardhurat nga paga e saj.

ABI¹⁰, ndër të tjera, ka konfirmuar se bashkëshortja e subjektit ka llogari rrjedhëse page, me gjendje në vlerën 7.714 lekë, në datën 27.1.2017.

✓ Nga verifikimi i kësaj llogarie deklarimi i subjektit përputhet me të dhënat e marra nga ABI.

Likuiditete të deklaruara nga personi lidhur, vajza e subjektit (M. B.)

9. Llogari kursimi, në vlerën 6.906 euro, me gjendje në datën 23.1.2017, në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të vajzës së subjektit.

9.1 Si burim krijimi është deklaruar: pakësim i gjendjes *cash* jashtë sistemit bankar, të deklaruara në vitin 2015, në shumën 3.500 euro, të përfituara si dhuratë nga të afërmit me rastin e fitimit të shkollës në Universitetin Katolik “***”; 450 euro të shtuara nga vajza në datën 5.1.2016, të grumbulluara nga të afërmit në festat e fundvitit; dhe 3.000 euro të dhuruara në datën 2.8.2016, nga xhaxhai i saj, z. A. B.

9.2 Hetimi lidhur me këtë llogari

Duke analizuar deklaratat e bëra në vite lidhur me këtë llogari, ka rezultuar se personi i lidhur (vajza e subjektit) ka deklaruar çdo depozitim të kryer, referuar deklaratave periodike vjetore për vitet 2014, 2015 dhe 2016.

Nga verifikimi i nxjerrjes së gjendjes së llogarisë në euro, evidentohet se z. A. B. ka depozituar *cash*, shumën 3.000 euro, në datën 2.8.2016

“Intesa Sanpaolo Bank”¹¹ ka informuar mbi llogarinë në këtë bankë në emër të vajzës së subjektit.

¹⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 27.2.2018.

¹¹ Shkresa nr. *** prot., datë 14.2.2018.

- ✓ Nga hetimi i kryer konfirmohet gjendja e kësaj llogarie, si dhe deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

9.3 Hetimi lidhur me dhuratën në vlerën 3.000 euro të vëllait të subjektit, në favor të vajzës së subjektit

Komisioni hetoi mbi burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar. Subjekti ka paraqitur dokumentacion provues mbi të ardhurat e ligjshme të vëllait, të realizuara dhe të deklaruara në shtetin grek, të cilat gjenden të administruara në dosjen hetimore.

Dokumentacioni provues

- Dokumentacioni i të ardhurave të ligjshme të deklaruara në shtetin grek, të përkthyer në shqip, të cilat rezultojnë në shumën 219.996 euro, për periudhën 2008 – 2017.
- Deklaratë noteriale, datë 8.2.2019, ku z. A. B. deklaroi se ka depozituar shumën 3.000 euro në llogarinë e znj. M. B.
- *Statement* bankar i llogarisë së znj. M. B. në “Intesa Sanpaolo Bank”, ku verifikohet depozitimi i shumës 3.000 euro, në datën 2.8.2016 nga z. A. B.
- ✓ Komisioni analizoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat e ligjshme nga punësimi në Greqi i vëllait A. B. dhe nga analizimi i këtyre të ardhurave ka rezultuar se ato janë në masë të mjaftueshme për të justifikuar dhënien e kësaj shume si dhuratë dhe mbulimin e shpenzimeve jetike të tij.

10. Llogari rrjedhëse në vlerën 68.432 lekë, me gjendje në datën 23.1.2017, në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të vajzës së subjektit M. B.

- ✓ Nga sa më sipër konstatohet se deklarimi i personit të lidhur përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

11. Llogari e kartës së parapaguar me gjendje 216 lekë, në emër të vajzës së subjektit.

“Intesa Sanpaolo Bank” ka konfirmuar llogarinë e kartës së kreditit në emër të vajzës së subjektit dhe gjendjen e saj në datën e deklarimit, në vlerën 216 lekë.

- ✓ Për sa më sipër konstatohet se deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të pasurisë

Nga hetimi i thellë administrativ për vlerësimin e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar elementë të cilat mund të ngrënë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme dhe pas verifikimit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

- ✓ Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, *ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të z. Dritan Banushi.*

Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga verifikimi i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim, DSIK-ja, pavarësisht të dhënave të siguruara nga autoritetet verifikuese, nuk ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimi për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

- ✓ Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Banushi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016;
- kriterëve të vlerësimit, të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, ka përgatitur raportin për analizën e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit z. Dritan Banushi. Në këtë raport janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit; të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Në analizë të raportit të vlerësimit të kryer nga KLD-ja duket se subjekti ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- i. raportit për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga Inspektorati i KLD-së dhe dokumentacionin bashkëlidhur tij;
- ii. vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese;
- iii. kriterëve të vlerësimit, të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Komisioni, me qëllim rivlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si edhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së. Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja nuk u konstatuan problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

Komisioni, në tërësi, vërejtë se subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor në vendimmarrjet e tij, si dhe ruan normat etiko-profesionale.

Komisioni konstaton se lidhur me njohuritë ligjore, subjekti ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Subjekti zotëron njohuri ligjore dhe të arsyetimit ligjor, referuar nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, si dhe ka aftësi organizative, referuar nenit 74/4/5, të ligjit nr. 96/2016.

Konstatohet se subjekti respekton etikën në punë dhe integritetin profesional dhe ka pasur gatishmëri për t’u angazhuar dhe i është nënshtruar programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, sipas nenit 76/4/5, të ligjit nr. 96/2016.

Denoncimet e publikut të depozituara në Komision

Në Komisionin janë depozituar 14 denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Banushi.

Komisioni, me qëllim vlerësimin etik dhe profesional të subjektit, verifikoi dhe analizoi me objektivitet të gjitha denoncimet e depozituara. Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

- ✓ Nga shqyrtimi në tërësi i këtyre denoncimeve duket se nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe figurën e subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Me cilësinë e relatores së çështjes, në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional, pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe pas hetimit të pavarur të Komisionit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Nuk u provua asnjë *indicie* apo element që të cenonte figurën e gjyqtarit, sipas parashikimeve në nenin 44/a, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit propozoj: ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Banushi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Banushi, me funksion gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.
2. Ky vendim i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 28.1.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI

Kryesuese

Suela ZHEGU

Relatore

Valbona SANXHAKTARI

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Etmonda Hoxha

